



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1354 / prot.
3

Tiranë më 12.12.2017

REKOMANDIM

Nr. 47 , datë 12.12.2017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44 datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Reisswolf Albania Shpk.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 259, datë 12.10.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Reisswolf Albania Shpk, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

I. Kontrolluesi Reisswolf Albania Shpk ka në objekt të veprimtarisë së tij arkivimin fizik dhe dixhital të dokumenteve dhe materialeve nëpërmjet një sistemi të integruar, si dhe shkatërrimin e dokumenteve. Këto shërbime ofrohen ndaj palëve të treta të kontraktuara. Menaxhimi fizik i arkivave fillon me transportin e dokumenteve pranë mjediseve arkivuese, dhe vijon me magazinimin dhe ofrimin e mjeteve mbështetëse për arkivimin e dokumentacionit (*database* dhe programe arkivimi). Shërbimi kryhet nëpërmjet ofrimit të mjeteve mbledhëse të dokumenteve për shkatërrim (kuti alumini me sisteme sigurie), menaxhimit, përgatitjes dhe monitorimit të dokumenteve për shkatërrim, shkatërrim të dokumenteve dhe materialeve të arkivuara të marra drejtpërdrejtë nga klienti, dhe pajisjes me certifikatën e shkatërrimit të dokumenteve. Rezulton se Reisswolf Albania Shpk nuk ka akses në të dhënat personale që përpunon për të tretët pasi kjo përbën edhe thelbin e shërbimit që ofron i cili ka si qëllim garantimin e konfidencialitetit dhe sigurisë së të

dhënave gjatë procesit të arkivimit dhe shkatërrimit të dokumenteve. Për këto lloj shërbimesh që ofrohen për llogari të të tretëve, Reisswolf Albania Shpk gëzon statusin e “përpunuesit”. Marrëdhënia midis tyre sanksionohet me marrëveshje të shkruar midis palëve.

2. Kontrolluesi Reisswolf Albania Shpk ka hartuar “Rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale”, por në përmbajtje të saj konstatohen mangësi sa i përket parashikimit të dispozitave lidhur me proceset e përpunimit. Rregullorja nuk është gjithëpërfshirëse nuk përfshin çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave sipas parashikimeve në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

3. Kontrolluesi, gjatë përpunimit të të dhënave personale të vizitorëve për hyrje-daljet dhe gjatë përpunimit të të dhënave personale në kuadër të aktivitetit specifik, nuk i informon subjektet e të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë sipas neneve 12, 13, 15, 16 dhe 17 të ligjit, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë.

Nga verifikimi i kryer në faqen online të kontrolluesit reisswolf.al, rezulton të mos jenë publikuar “Politikat e privatësisë” të kontrolluesit, duke mos u dhënë mundësi subjekteve të të dhënave të informohen mbi mundësinë e ushtrimit në praktikë të të drejtave të tyre, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

4. Reisswolf Albania Shpk në kuadër të ofrimit të shërbimit të arkivimit dhe shkatërrimit të dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale, për shoqëri/institucione të tjera, që sanksionohet me marrëveshje midis palëve, konsiderohet “përpunues” pasi i përpunon të dhënat personale të qytetarëve në emër dhe për llogari të këtyre shoqërive/institucioneve si përfituese të shërbimeve (në cilësinë e kontrolluesit). Në këtë kuadër, në raport me nenin 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, konstatohet se: Nuk janë marrë masa lidhur me garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale nëpërmjet parashikimit të dispozitave specifike në marrëveshjet me përfituesit e shërbimeve (në cilësinë e kontrolluesit), në kundërshtim me pikën 1/c të këtij neni;

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin e hetimit administrativ (datë 10.11.2017), si dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në datën 23.11.2017, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ.

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore ka depozituar prova në kuadër të masave të marra në zbatim të ligjit dhe rekuperimit të shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e hetimit administrativ, si më poshtë:

- Janë hartuar “Politikat e Privatësisë” për t’u publikuar në faqen online të kontrolluesit <http://reisswolf.al/>, në zbatim të detyrimeve të nenit 18 të Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
- Është hartuar rregullorja “Për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-survejitimit (CCTV)”, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 të Komisioncrit, datë 05/03/2010, “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.
- Është hartuar “Aneksi i Kontratës” mbi “Përpunimin e të dhënave personale/sensitive gjatë zbatimit të kontratës së shërbimit, në kuadër të delegimit të përpunimit për shërbimin e arkivimit dhe shkatërrim të të dhënave”, në zbatim të detyrimeve të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Lidhur me pretendimet e paraqitura me shkrim nga kontrolluesi mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

- Hartimi i “Rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në përputhje me proceset e përpunimit që kryen kontrolluesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë, është një detyrim i rëndësishëm, pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave për çdo punonjës dhe përcakton standardet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektsh të të dhënave.
- Informimi i subjekteve të të dhënave në përputhje me kërkesat e nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit. Ky detyrim qëndron ndaj Reisswolf Albania Shpk në cilësinë e kontrolluesit (kur përpunon të dhënat e vizitorëve gjatë hyrje-daljeve në ambientet e punës ose të dhënat nëpërmjet sistemit CCTV), por edhe ndaj përpunuesit (kur përpunon të dhënat personale gjatë shërbimit të arkivimit dhe shkatërrimit të dokumenteve për llogari të të tretëve). Format i “Politikave të privatësisë”, hartuar nga kontrolluesi, parashikon dhe qartëson kriteret ligjore që përbëjnë thelbin e detyrimit për informim.
- Në kuadër të garantimit të përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale dhe plotësisht të detyrimeve ligjore specifike lidhur me delegimin e shërbimit, është e rëndësishme që në kontratat që Reisswolf Albania Shpk ka lidhur me shoqëri/institucione përfutuese të shërbimit të arkivimit dhe shkatërrimit të dokumenteve, të reflektohen parimet, masat, të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në nenin 20 i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Në pjesën më të madhe të kontratave janë ezauruar detyrimet ligjore lidhur me delegimin e shërbimit. Garantimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave siguron përpunimin e ligjshëm, të saktë dhe të drejtë

të të dhënave personale. Pavarësisht statusit të Reisswolf Albania Shpk si përpunues, detyrimet që burojnë nga neni 20 i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, vlejnjë njësoj për të dyja palët “kontrollues” apo “përpunues”.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 29, 30 dhe 31/1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Reisswolf Albania Shpk, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë.
2. Reisswolf Albania Shpk, të ketë në vëmendje krijimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative, në marrëveshje me kontrolluesin, për përmbushjen e detyrimeve në zbatim të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Këto detyrime ligjore të reflektohen në të gjitha kontratat e shërbimit.
3. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, në “Rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale”, hartuar nga kontrolluesi, të parashikohen dispozita lidhur me proceset e përpunimit, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave.
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 12 / 12 / 2017

KOMISIONERI

Besnik Deryishi

